

<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODRNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</p>
---	--	--

ASC-09-0020

Në padinë e

1. [REDACTED]

2. [REDACTED]

Që të dy nga [REDACTED], Prishtinë,

Përfaqësuar nga avokati [REDACTED]

Rruga [REDACTED], Prishtinë

Paditësit

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Rruga Ilir Konushevcu 8, Prishtinë

I Padituri/Ankuesi

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, lidhur me ankesën e Të Paditurit/Ankuesit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 15 maj 2009, SCC-09-0056, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 prill 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazë. Aktvendimi i Trupit Gjykses (SCC-09-0056) i datës 15 maj 2009 vërtetohet.

Gjendja faktike dhe procedurale:

Më 22 prill 2009, Paditësit parashtruan një padi pranë DHPGJS-së duke kërkuar të drejtën për të përdorur një pjesë të ngastrës kadastrale [REDAKTUAR], e regjistruar në Fletën Poseduese [REDAKTUAR], vendi [REDAKTUAR], Zona Kadastrale e Prishtinës, për qasje në pronën e tyre (të afërt) për banim. Paditësit gjithashtu i kërkuan nga DHPGJS-ja ta ndalojë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) ta privatizojë ngastrën e lartpërmendur të shpallur si pronë e Ndërmarrjes së Re [REDAKTUAR] në valën e 34-t të privatizimit. Më 15 maj 2009, Trupi Gjykes i DHPGJS-së ka caktuar ndalimin e përkohshëm duke e ndaluar të Paditurin nga zhvillimi i çfarëdo procedure, të cilitdo lloj, lidhur me privatizimin e Ndërmarrjes së Re [REDAKTUAR] deri në aktgjykimin përfundimtar për lëndën SCC-09-0056. Përveç kësaj, Paditësit ishin të obliguar të parashtronin brenda 3 (tri) ditëve nga pranimi i aktvendimit një garancion bankar në shumën prej 500 eurove që të sigurojnë AKP-në për çfarëdo dëmsh nëse nuk vërtetohet padia. Pas dërgimit të aktvendimit, Paditësit parashtruan brenda afatit të paraparë garancion bankar pranë DHPGJS-së.

Më 10 qershor 2009, i Padituri (më tej Ankuesi) ka parashtruar një ankesë duke i kërkuar Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së ta anulojë aktvendimin i cili cakton ndalimin e përkohshëm. Ankuesi pohoi se aktvendimi ishte bazuar në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Me urdhrin e 8 shkurtit 2010, ankesa dhe dokumentet mbështetëse ishin dorëzuar tek Paditësit për përgjigje ndaj ankesës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i tij.

Më 8 mars 2010, Paditësit parashtruan një përgjigje ndaj ankesës duke kërkuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së ta refuzojë ankesën si të papranueshme. Paditësit pohuan se aktvendimi për caktimin e ndalimit të përkohshëm është i bazuar sepse është një garanci i të drejtave të tyre për ta përdorur pronën për banim. Paditësit theksuan se Ankuesi më parë u kishte ndaluar atyre qasjen në pronën e tyre dhe se kurrë nuk u ka ofruar atyre vërtetim me shkrim lidhur me të drejtat e tyre. Nëse Ankuesi lejohet të

vazhdojë me privatizimin e Ndërmarrjes së Re [REDACTED] atëherë ata do të privohen nga të drejtat e tyre pronësore.

Me urdhrin e DHPGJS-së së datës 19 mars 2010, përgjigja ndaj ankesës ishte dërguar tek Ankuesi dhe palët ishin njoftuar për Nenet 62.1 dhe 62.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Asnjë kërkesë nuk është parashtruar pranë DHPGJS-së nga palët në lidhje me nenet e lartpërmendura.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme, por e pabazë. Në pajtim me Nenin 63.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi të që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Neni 55.1 i UA të UNMIK-ut 2008/6 thekson se me kërkesë të palës, DHPGJS-ja mund të nxjerrë një aktvendim për masë të përkohshme nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për masë të përkohshme. Kërkesa për aktvendim për masë të përkohshme parashtrohet bashkë me padinë ose pas padisë së parashtruar në lidhje me atë padi.

Në rastin në fjalë kushtet e Nenit 55 të UA të UNMIK-ut 2008/6 përmbushen. Trupi Gjyqësor në mënyrë të drejtë ka pasur parasysh se Paditësit do të pësonin dëm të menjëhershëm pasi që Agjencia Kosovare e Privatizimit tashmë e ka shpallur pronën për privatizim dhe se një dëm i tillë do të ishte i pariparueshëm pasi që Paditësit do të mund të humbnin të drejtën e tyre për qasje në pronën e tyre për banim nëse do të vazhdonte privatizimi. Ankuesi nuk ka paraqitur fakte ose dëshmi se cilat të drejta pronësore të Paditësve do të garantohen nëse hiqet ndalimi i përkohshëm. Në fakt, Ankuesi ka theksuar se investitorët e mundshëm do të "njoftoheshin" mbi këto të drejta. Andaj, ndalimi i përkohshëm duhet të mbetet në fuqi deri në vendimin përfundimtar të padisë.

Në analogji me Nenin 12, paragrafi 1 i Ligjit mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 3 tetor 1987) Ankuesi lirohet

IV

nga taksat gjyqësore. Prandaj, nuk do të merret një vendim mbi taksat gjyqësore.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it _____nënshkruar_____

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it _____nënshkruar_____

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it _____nënshkruar_____

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it _____nënshkruar_____